VENDIM
Nr.853, datë 17.12.2004

PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË LEJES SË IMPORTIT, EKSPORTIT DHE PRODHIMIT TË LËNDËVE PIROTEKNIKE, FISHEKZJARRE, PËR PËRDORIM CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 te Kushtetutës dhe të neneve 7 e 9 të ligjit nr.9126, datë 29.7.2003 "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lëndët piroteknike, fishekzjarre, që lejohen të importohen, eksportohen apo prodhohen në Republikën e Shqipërisë, për përdorim civil, transformimi i të cilave bëhet vetëm me djegie, me shpejtësi 1- 10 m/sek, që lëshojnë flakë dhe dritë, me ndriçim, me ngjyra të ndryshme, përcaktohen në pjesën II klasa I grupet 3 e 4 në bashkësinë "G" (1.3G ose 1.4G) të ligjit nr.9272, datë 16.9.2004 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen europiane "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme ADR" dhe protokollin e nënshkrimit".

2. Leja e importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil, u jepet vetëm personave fizikë ose juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, nga komisioni i dhënies së lejeve në Ministrinë e Mbrojtjes, i ngritur në zbatim të vendimit nr.597, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave "Për procedurën për dhënien e lejes së importimit, eksportimit dhe të prodhimit të lëndëve plasëse për përdorim civil".

3. Leja e importit edhe eksportit të lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil, jepet brenda 30 ditëve nga data e aplikimit me shkrim të kërkuesit, ndërsa leja e prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil, jepet brenda 6 muajve nga data e aplikimit të kërkuesit.

4. Afati i vlefshmërisë së lejes për import dhe eksport të lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil, është 1-vjeçar, ndërsa afati i vlefshmërisë së lejes për prodhimin e këtyre lëndëve, për përdorim civil, është 5-vjeçar, me të drejtë rinovimi. Procedura e rinovimit të lejes është e njëjtë me atë të dhënies së saj.

5. Ministri i Rendit Publik përcakton, me udhëzim të veçantë, kohën, vendin dhe mënyrat e përdorimit të lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil.

6. Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me leje për import të lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil, paraqet në Ministrinë e Mbrojtjes kërkesën me shkrim, në formë autobiografie, me adresën e saktë dhe dokumentet e mëposhtme:

a) Regjistrimin në gjykatë si person juridik ose fizik, për import dhe tregtim fishekzjarresh;

b) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor;

c) Certifikatën e numrit të identifikimit si person i tatueshëm;

ç) Listën e hartuar nga prodhuesi i fishekzjarreve, me numrin e kodit, emërtimin e fishekzjarreve, mënyrën e paketimit, sasinë, peshën, vlerën financiare, të përkthyer në shqip dhe të noterizuar;

d) Lejen e dhënë nga Ministria e Mjedisit për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit;

dh) Lejen e dhënë nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi e qarkut për mjediset ku do të magazinohen fishekzjarret;

e) Kopjen e lejes së mëparshme të importit, në rast rinovimi.

Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara.

Subjekti i interesuar, para zhdoganimit të fishekzjarreve, bën në bankë një urdhërderdhjeje "Për likuidim detyrimi për marrjen e lejes së importit për fishekzjarret", për Ministrinë e Mbrojtjes.

7. Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me leje për eksport, të lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil, paraqet në Ministrinë e Mbrojtjes kërkesën me shkrim, në formë autobiografie, me adresën e saktë dhe dokumentet e mëposhtme:

a) Regjistrimin në gjykatë si person fizik ose juridik, për eksport dhe tregtim fishekzjarresh;

b) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor;

c) Certifikatën e numrit të identifikimit si person i tatueshëm;

ç) Listën e hartuar nga prodhuesi i fishekzjarreve, me numrin e kodit, emërtimin e

fishekzjarreve, mënyrën e paketimit, sasinë, peshën, vlerën financiare, të përkthyer në shqip dhe të noterizuar, nëse është e nevojshme;

d) Ceritifikatën e përdoruesit të fundit (END USER);

dh) Urdhërderdhjen "Për likuidimin e detyrimit për marrjen e lejes së eksportit për fishekzjarret" për Ministrinë e Mbrojtjes.

Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara.

Në rastet e mosdhënies së lejes së eksportit, Ministria e Mbrojtjes i kthen subjektit shumën në lekë, të derdhur për llogari të saj, sipas paragrafit të mësipërm.

8.A. Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me leje, për prodhimin e lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil, paraqet në Ministrinë e Mbrojtjes kërkesën me shkrim, në formë autobiografie, me adresën e saktë dhe dokumentet e mëposhtme:

a) Regjistrimin si person fizik ose juridik, për prodhim dhe tregtim fishekzjarresh;

b) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor;

c) Certifikatën e numrit të identifikimit si person i tatueshëm;

ç) Lejen e dhënë nga Ministria e Mjedisit për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit;

d) Patentën e prodhimit me llojet e fishekzjarreve, sipas vlerësimit të konformitetit, në mbështetje të ligjit nr.9126, datë 27.9.2003;

dh) Projektet e ndërtimit të uzinës, sipas standardeve, në rajonin ku do të vendoset linja e prodhimit të 1ëndëve piroteknike, fishekzjarre, të siguruara dhe të miratuara në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e) Lejen e dhënë nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi e qarkut, për mjediset ku do të magazinohen fishekzjarret.

B. Gjithashtu, subjekti:

a) duhet të ketë personel inxhiniero-teknik, mekanikë, kimistë me përvojë pune, jo më pak se 5 vjet, në fushën e prodhimit të lëndëve plasëse, dhe inxhinierë prodhimi me përvojë pune, jo më pak se 3 vjet në këtë sektor, të cilët duhet të kenë marrë pjesë në projektimin dhe prodhimin e jo më pak se 3 linjave teknologjike;

b) duhet të ketë siguruar mjetet e nevojshme të transportit dhe të ketë marrë masat e mbrojtjes nga zjarri, sipas legjislacionit në fuqi.

Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara.

Subjekti i interesuar, para marrjes së lejes për prodhimin e fishekzjarreve, bën në bankë një urdhërderdhjeje "Për likuidim detyrimi për marrjen e lejes së prodhimit të fishekzjarrëve", për Ministrinë e Mbrojtjes.

Në rastet e mosdhënies së lejes së prodhimit, Ministria e Mbrojtjes i kthen subjektit shumën në lekë, të derdhur për llogari të saj, sipas paragrafit të mësipërm.

9. Lëndët piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil, importohen në Republikën e Shqipërisë vetëm pasi të jenë kontrolluar nga personat e autorizuar nga komisioni i dhënies së lejeve të lëndëve piroteknike, fishekzjarre, sipas procedurave të konformitetit.

10. Lejet e përcaktuara në këtë vendim mund të hiqen me vendim të komisionit të dhënies së lejeve të lëndëve piroteknike, fishekzjarre, në raste kur:

a) subjekti kryen vepër penahe, që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë së importit, eksportit apo prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil;

b) subjekti, gjatë importit, eksportit apo prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil, shkel apo nuk plotëson rregullat teknike të prodhimit, përdorimit apo të konformitetit të lëndëve plasëse, duke rrezikuar mjedisin, jetën e njerëzve dhe të kafshëve, si dhe shkel kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

11. Personat e interesuar mund të ankohen kundër vendimeve të komisionit te Ministri i Mbrojtjes, në përputhje me ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

12. Tarifat financiare për dhënien e lejeve të importit, eksportit apo prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekzjarreve, për përdorim civil, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

13. Të ardhurat e siguruara nga dhënia e lejeve, sipas këtij vendimi, të përdoren në përputhje me vendimin nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore".

14. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Rendit Publik dhe Ministri i Financave që,

brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të nxjerrin aktet në zbatim të tij.

15. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano